



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
MINISTRI

Nr. 21/3 Prot

Tirane, më 17.07 2011

U R D H Ë R

Nr. 21 Datë 17.07 2011

“PËR MIRATIMIN E SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E
SHOQËRISË “BURSA E TIRANËS” SH.A”

Nëmbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 2 gërma “b” dhe pikës 4 të nenit 135, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ministri i Financave në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë aksionare “Bursa e Tiranës” sh.a

U R D H Ë R O N :

1. Miratimin e shtesave dhe ndryshimeve në Statutin e Shoqërisë “Bursa e Tiranës” sh.a.
2. Ngarkohet “Bursa e Tiranës” sh.a për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

RIDVAN BODE

MINISTER



STATUT

!

SHOQËRISË ANONIME

"BURSA E TIRANËS"sh.a



KAPITULLI I

FORMA, EMËRTIMI, SELIA DHE OBJEKTI

NENI 1

FORMA JURIDIKE

"Bursa e Tiranës" sh.a, themelohet në formën e shoqërisë aksionere, pa ofertë publike dhe funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit Nr. 9879 datë 21.02.2008 "Për titujt".

NENI 2

EMËRTIMI I SHOQERISE

Emërtimi i plotë i shoqërisë është "Bursa e Tiranës" sh.a.
Shoqëria ka dhe emrin e saj të shkurtuar i cili është "BT".
Emërtimi i shoqërisë në gjuhë të huaj është "Tirana Stock Exchange".

NENI 3

VULA, STEMA

Shoqëria "Bursa e Tiranës" sh.a, ka stemën dhe vulën e saj që përmban emërtimin e plotë të saj "Bursa e Tiranës" sh.a.
Konfiguracioni i stemës përcaktohet e ndryshohet nga Këshilli Mbikëqyrës.
Vula e shoqërisë përdoret vetëm për dokumentat në marrëdhënie me të tretët.
Stema, emërtimi i plotë i shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a dhe adresa e plotë e selisë së saj përfshihen në të gjitha aktet dhe dokumentat e shoqërisë.

NENI 4

SELIA

Selia e shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a, është në adresën Rr. "Dora D'Istria" Nr. 2, Tiranë.



NENI 5

KOHEZGJATJA

Bursa e Tiranës themelohet dhe ushtron veprimtari në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe këtij statuti për një afat kohor të pacaktuar.

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Të sigurojë një treg titujsh të hapur, transparent, të barabartë, eficient dhe ekonomik.
Të rregullojë, të lehtësojë dhe të përmirësojë tregtimin në tiliuj.
Të krijojë përputhshmërinë me parimet e drejta dhe të implementojë procedura të drejta dhe korrekte në tregun e organizuar të tiliujve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET

NENI 7

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a është 20 milion lekë .
Ky kapital zotërohet nga shteti Shqiptar, i përfaqësuar nga Ministri i Financave.

Ai është i ndarë në 20 mijë aksione me vlerë nominale prej 1000 lekë për çdo aksion.

Aksionet janë të numëruara nga 1 deri në 20.000, përfshirë numrin e fundit të aksionit.



NENI 8

ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Zmadhimi i kapitalit themeltar, kryhet me vendim të Aksionarit të vetëm.

Administratori njofton për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për zmadhimin e kapitalit themeltar. Aplikimi për regjistrimin e vendimit, shoqërohet me raportin e ekspertit kontabël të autorizuar, ku verifikohet vlera e kontributeve në natyrë sipas nenit 113 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Informacioni shoqëruar përfshin listën e personave që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumën e paguara. Kjo listë nënshkruhet nga Administratori.

Zmadhimi i kapitalit themeltar bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 9

ZMADHIMI I KAPITALIT ME EMETIM TE AKSIONEVE TE REJA

Kapitali i regjistruar i shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a, mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.

NENI 10

ZMADHIMI I KUFIZUAR I KAPITALIT

Aksionari i Vetëm, vendos që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, vetëm me miratimin e Tij.

NENI 11

ZMADHIMI I AUTORIZUAR I KAPITALIT

Statuti ose/dhe Vendimi i Aksionarit të Vetëm për ndryshime në statut, mund t'i japë administratorit të drejtën për të kryer, brenda një afati 5 vjeçar nga regjistrimi i shoqërisë, zmadhim të kapitalit me emetim të aksioneve të reja, për një vlerë maksimale të përcaktuar (kapital i autorizuar).

Vlera e zmadhimeve të autorizuara, nuk mund të jetë më e madhe se gjysma e kapitalit të regjistruar të shoqërisë në datën në të cilën merret vendimi për zmadhimin e autorizuar.



NENI 12

ZMADHIMI I KAPITALIT ME AKTIVE TE SHOQERISE

Aksionari i vetem ka të drejtë të vendosë zmadhimin e kapitalit të regjistruar, pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar ose përtej një vlerë më të lartë të rezervës së përcaktuar në statut mund të kalohen në kapitalin fillestar.

Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

Regjistrimi i vendimit të zmadhimit të kapitalit sipas kësaj mënyre, duhet të shoqërohet nga bilanci në bazë të të cilit është zmadhuar kapitali, nga konfirmimi i ekspertit kontabël të autorizuar dhe pasqyrat e fundit të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Njoftimi për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit duhet të përcaktojë se zmadhimi i kapitalit është kryor me kalimin e rezervave të shoqërisë ose me fitimin e pashpërndarë.

NENI 13

ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Aksionarit të Vetëm.

Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, duke përmbushur kërkesat formale të nenit 149 /3 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve.

Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori



Kapitali quhet i zvogëluar, nga çasti i regjistrimit të vendimit.

NENI 14

ZVOGELIMI I THJESHTEZUAR I KAPITALIT

Zvogëlimi i kapitalit për mbulimin e humbjeve, si dhe transferimi i fondit të rezervave kryhen nëpërmjet një procedure të thjeshtuar.

NENI 15

ZVOGELIMI I KAPITALIT ME ANULIM AKSIONESH

Zvogëlimi i kapitalit realizohet edhe nëpërmjet anulimit të aksioneve.

Anulimi i aksioneve duhet të përmbushë kërkesat për zvogëlimin e zakonshëm të kapitalit. Në këtë rast vendimi i Aksionarit të vetëm zëvendësohet nga vendimi i Administratorit.

Dispozitat për zvogëlimin e zakonshëm të kapitalit nuk janë të zbatueshme nëse aksionet, kontributot e të cilave janë shlyer tërësisht, i kalohen Shoqërisë pa kundërshpërbllim.

Kapitali quhet i zvogëluar, duke filluar nga çasti i regjistrimit të vendimit.

NENI 16

VLERA NOMINALE DHE EMETIMI I AKSIONEVE

Çdo aksion ka të njëjtën vlerë nominale.

Aksionet nuk mund të emetohen përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Aksionet e emetuara më parë janë të pavlefshme.

NENI 17



REGJISTRIMI I AKSIONEVE

Shoqëritë aksionare mbajnë një regjistër të posaçëm, në të cilin regjistrohen të dhënat e zotëguesve të aksioneve të Shoqërisë në zbatim të dispozitave të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

Personat e regjistruar prezumohen si aksionarë të shoqërisë me të drejta të plota si në marrëdhëniet me shoqërinë ashtu edhe ndaj të tretëve.

Administratori është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohet të lejojë aksesin në informacionet e regjistrit, aksionarit apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë.

NENI 18

TE DREJTAT E PRONESISE NE BURSEN E TITUJVE

Aksionet e Shoqërisë "Bursa e Tiranës" sh.a që vepron si bursë fitujsh, zotërohen vetëm nga Qeveria Shqiptare.

Aksionet e kësaj shoqërie me kapital tërësisht shtetëror nuk mund t'u transferohen të tretëve, veçse në rastin e privatizimit të kësaj shoqërie, ose në rast kur legjislacioni në fuqi do të kërkojë ndryshim të përqindjes së pronësisë së shtetit.

KAPITULLI III

DREJTIMI ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

NENI 19

ORGANET E SHOQERISE

Organet e Shoqërisë Aksionare "Bursa e Tiranës sh.a" janë:

- Aksionari i vetëm, Shteti, i përfaqësuar nga Ministri i Financave
- Këshilli Mbikqyrës
- Administratori

NENI 20



KOMPETENCAT E AKSIONARIT TE VETEM

Çështjet e lidhura me veprimtarinë dhe funksionimin e Shoqërisë, ushtrohen nga Aksionari i Vetëm. Aksionari i vetëm, merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të Statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) miratimin e skemës së shpërblyemeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të këtij neni ;
- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursë së veprimtarisë;
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- gj) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji.

NENI 21

VENDIMET E AKSIONARIT TE VETEM

Aksionari i vetëm, merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit Mbikqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Të gjitha vendimet e marra nga Aksionari i vetëm, regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme :

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporte të ecursë së veprimtarisë.
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit
- d) vendimet për investime
- e) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur



shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të notave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 22

KESHILLI MBIKËQYRES

PERBERJA DHE EMERIMI I KESHILLIT MBIKËQYRES

Këshilli Mbikëqyrës i Bursës së Tiranës përbëhet nga 5 anëtarë.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga Ministri i Financave në përputhje me kritere të përcaktuara në akte neneligor,

Kohëzgjatja e funksionit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është për një afat tre vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të shkarkohen për arsye të legjilmuara në çdo kohë nga Ministri i Financave.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri.

NENI 23

KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKËQYRES

Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori. Ai i jep këtij të fundit autorizim për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen pa autorizimin e Këshillit Mbikëqyrës
- b) të përgatisë, me kërkesë të Aksionarit të Vetëm, marrjen e masave, që janë në kompetencë të këtij të fundit, t'i rekomandojë atij vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e tij;
- c) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- ç) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- d) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'iu paraqitur Aksionarit të vetëm, së bashku me një raport të Këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- dh) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar Aksionarit të vetëm, t'u

vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i Këshillit Mbikëqyrës, përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

- e) të emërojë, të shkarkojë, të përcaktojë kompetencat e Administratorit;
- ë) të përcaktojë shpërblimin e Administratorit;
- f) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj;
- g) të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e komiteteve të Këshillit Mbikëqyrës;
- h) të miratojë masa disiplinore të propozuara nga Komiteti Disiplinor;
- i) të emërojë anëtarët e komiteteve të Bursës së Tiranës;
- j) të miratojë strukturën organizative të Bursës së Tiranës;
- k) të miratojë numrin e përgjithshëm të punëmarrësve të Bursës së Tiranës kriteret e vendeve të punës, pagat dhe shpërblimet e personelit;
- l) të pezullojë ose heqë nga listimi çdo titull kur e gjykon të arsyeshme me qëllim mbrojtjen e investitorëve apo ruajtjen e një tregu të rregullt;
- m) të miratojë heqjen e titullit nga tregtimi në Bursën e Tiranës;
- n) të miratojë apo heqë të drejtën për listim;
- o) të miratojë apo heqë të drejtën për anëtarësim;
- p) të miratojë librin e urdhrave si dhe çdo të drejtë dhe detyrë që i njihet apo i përcaktohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 24

RREGULLORET, KRYETARI DHE KOMITETET E POSAÇME

Këshilli Mbikëqyrës zhvillon mbledhjet e tij pranë selisë së Shoqërisë.

Statuti dhe Këshilli Mbikëqyrës përcaktojnë rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve.

Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për këto rregullore merren në mënyrë unanime.

Këshilli Mbikëqyrës zgjedh Kryetarin dhe Nënkyetarin e tij, në përputhje me dispozitat e Statutit. Kryetari, drejton mbledhjen, diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta. Nënkyetari ushtron tagrat e Kryetarit, kur ky i fundit është në pamundësi për t'i kryer ato personalisht. Një administrator nuk mund të zgjidhet Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës.

Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës regjistrohet në një proces-verbali, i cili nënshkruhet nga Kryetari.

Proces-verbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e proces-verbalit nuk sjellin pavlefshmërinë e vendimeve të marra.



Secili anëtar ka të drejtë të pajiset me një kopje të proces-verbalit. Kryetari dhe zëvendeskryetari i Këshillit Mbikëqyrës janë persona fizika. Në rast lirimi, i rizgjedhuri plotëson mandatin e paraardhësit.

Këshilli Mbikëqyrës mund të krijojë komitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e vet, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të Këshillit. Secili komitet duhet të përbëhet në shumicën e vot nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë.

NENI 25

MARRJA E VENDIMEVE

Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme, nëse në procesin e vendim-marrjes janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Kur për një çështje ka barazim votash, vota e Kryetarit mbizotëron.

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës merren bazuar në këtë Statut e në rregulloret e Këshillit, duke shprehur votën me shkrësë, me video konferenca, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i Këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendim-marrjeje.

NENI 26

SHPËRBLIMI

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës do të shpërblehen në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave.

NENI 27

ADMINISTRATORI

EMERIMI, DHE SHKARKIMI

Administratori emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës, për një afat tre vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori është person fizik, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit .



TE DREJTAT DHE DETYRAT

Administratori ka këto të drejta e detyra:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilën ia paraqet Këshillit Mbikëqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga Aksionari i vetëm;
- d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
- e) të raportojë përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e Shoqërisë;
- ë) të kryejë mbikëqyrjen e përgjithshme dhe drejtimin e përditshëm të Bursës së Tiranës, për të siguruar funksionimin e saj normal, si dhe për kryerjen e punës me efektivitet dhe arrijen e objektivave të pecaktuara;
- f) të mbikëqyrë aktivitetin e tregtimit në Bursën e Tiranës, kloringun dhe shlyerjen e llogarive për transaksionet e ekzekutuara në Bursën e Tiranës sipas akteve rregullative të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës e legjislacioni në fuqi;
- g) të relatojë në Këshillin Mbikëqyrës të gjitha problemet që rrjedhin nga aktiviteti i Bursës së Tiranës lidhur me tregtimin, listimin dhe anëtarësimin;
- h) të lidhë kontratat e punës me personelin e Bursës së Tiranës, sipas vendeve të punës të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës;
- i) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut që i shërben mbarëvajtjes normale të veprimtarisë së përditshme të Bursës së Tiranës;
- j) të lidhë dhe nënshkruajë kontrata, marreveshje, aktmarreveshje me të tretët sipas objektit të funksionimit të Shoqërisë;

Detyrat, që i cakton ligji Keshillit Mbikëqyrës, nuk mund t'i delegohen Administratorit.



NENI 29

INFORMACIONI KONFIDENCIAL

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Administratori si dhe punonjësit e tjerë të shoqërisë detyrohen të ruajnë Konfidencialitetin profesional, gjatë qëndrimit dhe pas largimit nga shoqëria për të dhëna që kanë karakter të brendshëm.

NENI 30

NDALIMI, KONFLIKTI I INTERESIT

Personat, që janë dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e veprave penale, të parashikuara në kreun III të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, për një afat deri në 5 vjet nga data e këtij dënimi, nuk mund të mbajnë funksionet e përfaqësuesit ligjor, nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.

NENI 31

NDALIMI I KONKURENCËS

Aksionerët, Administratori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, përjashtohen nga Shoqëria në rast se ushtrojnë për llogari të tyre apo të të tretëve aktivitete konkurrence me aktivitetin e Shoqërisë.

Nëse ndonjë nga të sipercituarit, shkel ndalimin e konkurrencës, Shoqëria mund:

- a) t'a përjashtojë atë nga Shoqëria apo t'a shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

NENI 32

EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

EMERIMI DHE SHPERBLIMI

Aksionari emëron një ose disa ekspertë kontabël të autorizuar.

Çdo ekspert kontabël i autorizuar qëndron në këtë detyrë për një vit financiar të shoqërisë.





NENI 37

REZERVA LIGJORE DHE REZERVAT E TJERA

Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpëzimet, Shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore të paktën 5(pesë) për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10(dhjetë) për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut.

Aksionari rezervon të drejtën e krijimit të rezervave të tjera nga fitimet vjetore.

Shoqëria llogarit e ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumat e caktuara për rezervat e përmendura më sipër.

NENI 38

DEKLARIMI I DIVIDENTIT

Dividendi është pjesa që i takon aksionarit nga vlera e fitimeve vjetore,

Fitimet vjetore llogariten në përputhje me parimet e përcaktuara nga ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Aksionari rezervon të drejtën të vendosë që Shoqëria të mos shpërndajë dividendë ose që fitimi vjetor të përdoren për qëllime të tjera.

NENI 39

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje e në zbatim të plotë të këtij Statuti, Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjit Nr. 9879 datë 21.02.2008 "Për titujt", Kodit Civil dhe gjithë legjislacionit në të cilin mbështetet veprimtaria e Shoqërisë në Republikën e Shqipërisë.

